


NE I NDIHMOJMË



DEMOKRACISË SONË

E ARDHMJA E NDRITUR

TRUMZA (11), ERJON E. (10), ORES (11), ZOTËRIM (11), MELISA (11), ERJON R. (11) ERËZA (11),

ENEA (10)



Ne punojmë për një demokraci më të suksesshme

Demokracinë ne e njohim si pëllëmbën e dorës. Edhe pse jemi të vegjël, ne dijmë shumë gjëra, siç është e drejta për shkollim, e drejta për lojë, e drejta për lëvizje, etj. Ne duhet të punojmë për të ardhmen, sepse ne mund të jemi ata të cilët mund ta bëjmë ndryshimin. Përderisa kemi të drejtë të shkollohemi, ne në vazhdimësi vetëdijësohemi më shumë dhe në këtë mënyrë ne e dijmë se çka i duhet shtetit tonë që të ketë një demokraci të plotë dhe të pastër. Të mirat e demokracisë janë të pafundme, prandaj edhe shquhet si forma më e mirë e udhëheqjes. Por, a e dini pse? Sepse demokracia përmban elemente me vlerë të madhe, të cilat duhet t'i zbatojmë të gjithë qytetarët e Kosovës.

Këto elemente janë: respekti ndaj njëri-tjetrit, solidariteti, toleranca, etj. Për shembull, një nxënësit të sapoardhur në klasën tonë i kemi ndihmuar për të mos u ndjerë i vetmuar. Me fjalët tona të ëmbla dhe veprimet tona bëjmë që shoku ynë ta ndjejë ngrohtësinë në klasë. Fjala demokraci rrjedh nga greqishtja e vjetër dhe në gjuhën shqipe do të thotë udhëheqje e popullit. Në Kosovë, qytetarët e ushtrojnë sovranitetin duke i zgjedhur përfaqësuesit e tyre, e këta përfaqësues janë deputetët, të cilët janë të obliguar t'i mbrojnë interesat dhe t'i përmbushin nevojat e qytetarëve.

Të dashur lexues, ne sot gjithashtu mësuam se racizmi është një fenomen negativ, prandaj urojmë që në çdo vend të botës të ketë barazi dhe paqe.



Dhe ne e duam tokën e pastër



Autorët e artikullit

QYTETARIA DEMOKRATIKE

BLERON (10), DIELLI (11), ALUIT (11), ENDI (11), SIDORELA (10), POEMA (10), GRANIT (11), ENSAR (11),

RIOLA (11)

Ne si gazetarë jemi edhe qytetarë aktiv, sepse po iu informojmë juve më shumë për demokracinë

Qytetar aktiv është një njeri që merr iniciativa të ndryshme për të mirën e përgjithshme. Ne si qytetarë të Republikës së Kosovës kemi nevoja të ndryshme, si të shkollohemi, të flasim lirshëm, të luajmë, etj. Këto nevoja na i siguron një sistem i qeverisjes që quhet demokraci.

Shteti i Kosovës është shtet i pavarur dhe demokratik. Pasi që shteti ynë na i përmbush nevojat tona, atëherë ne duhet t'ia kthejmë këto të mira duke u bërë qytetarë aktiv, si p.sh. ta mbrojmë ambientin, të respektojmë të tjerët dhe ligjet, të jemi solidarë, tolerantë, human dhe të mirëkuptohemi me të tjerët.



Gazetarët aktiv

Ensar,
si thua, a pajtohesh
që të marrim një iniciativë
me temë "Ta mbrojmë
ambientin"?



Poema duke i bërë Ensarit një pyetje

Kjo
është një ide shumë e
mirë



Ensari mendon se është ide e mirë

Po,
është e vërtetë, sepse
ndoshta shumë qytetarë mund të
vetëdijësohen



Iniciativa e tyre është shumë e drejtë

Qytetare aktive



Qytetare pasive



Dallimi mes një qytetareje aktive dhe asaj pasive

ZGJEDHJET DHE DEMOKRACIA

ERI (10), EVELINA (10), RRUMEJSA (10), ADONIS (10), AGON (11), ARBA (10), ZIJA (12)

Sa janë të rëndësishme zgjedhjet në demokraci? A e kanë të drejtën e votës së lirë qytetarët në demokraci? Cila është moshë kur qytetarët kanë të drejtë të votojnë në procesin zgjedhor? Për t'i kuptuar të gjitha këto, lexojeni këtë artikull

Ne jemi disa nga nxënësit e klasës V-2, të shkollës „Mustafa Bakija“ nga Gjakova, dhe sot patëm mundësi të flasim për zgjedhjet. Në grup diskutuam dhe treguam shembuj të ndryshëm, kur ne kemi mundësi të zgjedhim në jetën e përditshme. Në klasën tonë ne zhvillojmë shpesh kuize, ndahemi në grupe dhe pastaj zgjedhim së bashku kryetarin që do ta përfaqësojë grupin gjatë kuizit. Si shembull tjetër kemi përmendur edhe rastin kur ne zgjedhim lojën që dëshirojmë ta luajmë. Në demokraci, proces shumë i rëndësishëm është procesi zgjedhor, sepse populli përmes zgjedhjeve vendos se kush do ta udhëheqë vendin.

Duke pasur parasysh që rëndësia e votës është shumë e madhe, atëherë qytetarët duhet të informohen sa më shumë për kandidatët që dëshirojnë ta përfaqësojnë popullin. Në Kosovë, në procesin zgjedhor votohen deputetët si përfaqësues të popullit.



Grupi „Demos-Fantastikët“




Një intervistë me një qytetar, i cili flet për zgjedhjet në demokraci



Ne, populli jemi ata të cilët ndikojmë në zhvillimin e vendit tonë



Procesi zgjedhor



Demokracia dhe të drejtat e barabarta


KUVENDI YNË

ENDRIT (11), ERBLINA (13), BRETA (9), ELMA (11), UARDA (10), ULIKS (11), ORGES (11), ALTIN (10)



Artikulli ynë përmban informata të dobishme në lidhje me institucionin më të lartë demokratik, e që është Kuvendi

A keni provuar ndonjëherë të luani ndonjë aktivitet pa rregulla? Sigurisht që jo, sepse loja nuk do të mund të zhvillohej pa rregulla. E, kur një lojë nuk mund të funksionoj pa rregulla, a mund të funksionoj një shtet? Epo lexues të dashur, besoj që e dini se përgjigja është jo. Një shtet pa rregulla nuk do të kishte progres



dhe as sukses. Për këtë arsye, secili shtet ka rregulla e këto rregulla quhen ligje. Por, a e dini nga dalin ligjet? Ekziston një institucion që ka për detyrë të bëjë miratimin e ligjeve, e ky institucion është Kuvendi i Kosovës. Pikërisht Kuvendi ishte tema e diskutimit në grupin tonë. Kur jemi te grupi, duam t'iu tregojmë se grupi ynë quhet „Perlat e Përgjegjshme“. Gjatë diskutimit në grup, ne e kuptuam rëndësinë që ka Kuvendi ynë. Thamë se Kuvendi bën miratimin e lig-

jeve. Ligjet ndikojnë drejtpërdrejt në jetën tonë. Nëse në Kuvend miratohet një ligj që thotë se ne si nxënës duhet të qëndrojmë në shkollë nga ora 6 e mëngjesit deri në ora 6 në mbrëmje, atëherë ne pa dyshim se duhet ta respektojmë këtë ligj. E shihni pra, se sa i rëndësishëm është Kuvendi në jetën tonë? Miratimi i ligjeve njihet si funksioni legjislativ i Kuvendit. Përpos këtij funksioni, Kuvendi ka edhe dy funksione të tjera që janë: funksioni përfaqësues, sepse deputetët janë përfaqësuesit tanë në Kuvend, si dhe funksioni kontrollues, sepse Kuvendi kontrollon punën e Qeverisë. Kjo për shkak se Qeveria është institucioni që më së shpeshti dërgon projektligje në Kuvend. Pastaj, këto projektligje shqyrtohen dhe nëse votohen nga më shumë se gjysma e deputetëve, hyjnë në fuqi dhe bëhen ligje. Informacionet që sot i morëm na kanë bërë të kuptojmë se Kuvendi vërtetë ka peshë të madhe në jetën e gjithë qytetarëve.



„Perlat e Përgjegjshme“



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Mustafa Bakija“
Klasa: V-2
Vendi: Gjakovë